



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 12.3.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR SHPËRNDARJEN E ENERGIJË ELEKTRIKE I””

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 12 mars 2019, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I””. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektligj znj. Antoneta Dhima.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin për shqyrtim në Kuvend mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Marrëveshja, që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, synon sigurimin e financimit për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”. Ky projekt ka qëllim përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve në rrjet, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që të përfitojë:

- një kredi të butë nga KFW me vlerë të përgjithshme deri në **30 milionë euro** dhe
- një shumë financimi me vlerë të përgjithshme deri në **2 milionë euro** për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Kjo marrëveshje është marrëveshje kuadër dhe financimi do të jepet për çdo projekt që do të mbështetet nga palët deri në fund të vitit 2022. Huaja mund t’i jepet drejtpërdrejt Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose u jepet huamarrësve të tjerë dhe, në këtë rast, Këshilli i Ministrave është në rolin e garantuesit. Përzgjedhja e huamarrësve të tjerë do të bëhet bashkërisht nga të dyja qeveritë. Marrëveshja mund të zbatohet edhe në periodat e mëvonshme, nëse KFW bie dakord të japë hua ose shuma të tjera financimi për këtë projekt.

Kredia e butë do të jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim. Kushtet për përfitimin e saj janë që Republika e Shqipërisë të vijojë të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe që Këshilli i Ministrave të japë garanci shtetërore, nëse nuk është vetë huamarrës. Projekti për kredinë e butë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera, ndërsa shuma e financimit mund të përdoret për projekte të tjera, nëse palët bien dakord.

- ***Efektet financiare të projektligjit.***

Projektligji nuk ka efekte financiare shitesë në buxhet, me përjashtim të efekteve që mund të vijnë nga normat minimale të interesit që do të aplikojë huamarrësi në momentin e disbursimit, pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas. Buxheti i shtetit është në rolin e garantuesit të huas.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatorja paraqiti projektligjin, duke u ndalur në rolin që ai do të luajë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Zëvendësministri i Financave theksoi se procesi përgatitor për këtë marrëveshje ka nisur prej kohësh dhe synimi i palës shqiptare ka qenë plotësimi i kushteve dhe objektivave të rëna dakord nga palët. Performanca e OSHEE dhe e sektorit elektroenergjitik është përmirësuar ndjeshëm aktualisht, prandaj ekzistojnë të gjitha mundësitë për të thithur këtë kredi. Kredia do të shërbejë për rritjen e cilësisë së kontrollit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për të nxjerrë të dhëna më të sakta mbi humbjet në rrjet dhe shkaqet e tyre. Kredia do të luajë rol të rëndësishëm në mbështetjen e sektorit energjitik të vendit.

Anëtarët e Komisionit mbështetën mendimin që performanca financiare e OSHEE, sha-së dhe situata energjitike në vend janë përmirësuar ndjeshëm, që prej vitit 2014. Janë reduktuar ndjeshëm humbjet në rrjet. Mbështetja buxhetore për sektorin energjitik është rritur, megjithë thellimin e konsolidimit fiskal të vendit. Sektori energjitik karakterizohet nga rritja e investimeve dhe përmirësimi i infrastrukturës. Megjithatë, moti i thatë dhe disa faktorë të tjerë e kanë vënë në vështirësi këtë sektor. Për t'u njohur më në thellësi me situatën aktuale të sektorit energjitik, investimet, si dhe vizionin, strategjitë e planin për zhvillimin e këtij sektori në të ardhmen, së afërmi Komisioni do të zhvillojë një seancë dëgjimore me Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe administratorët e tri shoqërive që ushtrojnë veprimtari në këtë sektor, si KESH, sha, OST, sha dhe OSHEE, sha.

- ***Përfundim.***

Si konkluzion, Komisioni është i mendimit se marrëveshja është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030, Planin për Rimëkëmbjen e Sektorit Energjitik, të rishikuar, dhe të gjitha dokumentet e tjera për mbështetjen e sektorit energjitik. Ajo ka rëndësi të veçantë, pasi do të kontribuojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve në rrjet, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurisë në furnizimin e përdoruesve të energjisë elektrike. Financimi do të sigurohet nëpërmjet një kredie me terma të buta, duke mos rënduar buxhetin e shtetit. Për këto arsye, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORJA

Antoneta DHIMA

KRYETARI

Arben AHMETAJ